



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 19 prill 2011

**Shënimi i takimit të 4 mes BE – komitetit të përbashkët konsultativ të shoqërisë civile të ish republikës Jugosllave të Maqedonisë, Shkup 19 prill, 2011**

Vendi: Hotel Holiday Inn Shkup  
Hapsira: Milenium 2

Fjalim

Ambasador  
z. Piter SØRENSEN  
Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian

I nderuar Zëvendëskryeministër Naumovski; e nderuar Ko-kryesuese znj. Grupçeva i znj. Raunemaa; të nderuar anëtarë të Komitetit të përbashkët konsultativ, zonja dhe zotëri;

Është kënaqësi e madhe që jam prezent në sesionin hyrës të takimit të 4 të Komitetit të përbashkët konsultativ të shoqërisë civile. Komitetet evropiane ekonomike dhe sociale (EESC) përmes lidhjeve të tyre me grupe ekonomike dhe grupet me interes social janë partner vital për të gjithë – por, më së shumti për angazhimin të deklaruar për integritet evropian. Seksioni i EESC për marrëdhënie të jashtme ka formuar Komitet të përbashkët konsultativ të cilët luajnë rol të rëndësishëm për promovimin e vlerave mbi të cilët bazohen integritet evropian. Duke i marrë të gjitha këto fakte parasysh unë jam shumë i kënaqur që jam sot prezent këtu.

Takimi i sotshëm është duke ndodhur në fazë të rëndësishme të procesit të anëtarësimit në BE të vendit. Siç e dimë, Komisioni Evropian në vitin 2009 dha rekomandim për fillimin e bisedimeve për anëtarësim me vendin. Në atë kohë Komisioni besonte – edhe për momentin beson – se vendi është i përgatitur për të hyrë në fazë më të lartë të integritet në Evropë. Përmes përsëritjes së rekomandimeve për fillimin e negociatave, Komisioni e konfirmoi se vendi në masë të madhe i ka plotësuar kriteret politike – por ata gjithashtu theksuan se përpjekje të vazhdueshme janë të domosdoshme në shumë fusha.

Në këtë fazë, është me rëndësi që impulse i reformave të përmbahet – dhe në disa sfera bile edhe të përshpejtohen. Raporti i fundit i progresit e theksoi nevojën për përparim në sfera në vijim: (i) dialogu politik, (ii) reformat juridike dhe reformat në administratën publike, (iii) lufta kundër korrupsionit, liria e shprehjes dhe e mediave, dhe (v) implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Këto janë çështje, që ne në Delegacionin e Bashkimit Evropian vazhdojmë ti monitorojmë dhe të përqendrohemi për raportin e sivjetmë. Natyrisht, zgjedhjet e ardhshme do të na e tërheqin vëmendjen nga puna e jonë të ditëpërditshme për disa nga këto çështje. Megjithatë, kjo është një arsye për ne të presim zgjedhje të mira, solide, të lira dhe fer të cilat do ta çimentojnë vazhdimësinë e plotësimit të kriterëve politike, të cilët janë shumë të rëndësishme për procesin e pranimit.

Një mësim i mësuar nga raundi i mëparshëm i zgjerimit është se shkalla e përgjithshme e procesit të reformave do të thotë se askush nuk mund ta mbajë barrën vetë. Andaj, organizatat e shoqërisë civile, duhet të luajnë rol të rëndësishëm si “urë” mes njerëzve dhe institucioneve kombëtare. Përfaqësues të grupeve tematike të OJQ-ve mund të jenë crucial për ti ndihmuar legjislatit për ti sjellur vendimet e duhura. Për këtë arsye, Komiteti i përbashkët konsultativë i shoqërisë civile paraqet forum të shkëlqyeshëm ku sfida dhe eksperiencia të rëndësishme që kanë të bëjnë me pranimin mund të diskutohen

Dialogu social është një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet vendi në rrugën drejt integritet në BE. Partnerët social duhet të shihen si lojtarë të domosdoshëm dhe duhet krejtësisht të integrohen në dialogun politik. Në Raportin e fundit të progresit të Komisionit Evropian formimi dhe puna e Këshillit ekonomik dhe social u përshëndet.

Megjithatë, Raporti i Progresit gjithashtu qartë theksoi se nevojiten më shumë përpjekje për t'u siguruar pjesëmarrje adekuatë dhe efektive të partnerëve social në procesin e zhvillimit të politikave. Kjo është një sfidë për të gjitha pjesëmarrësit në politikë.

Siç tha Zëvendëskryeministri, edhe unë personalisht besoj se në gjendjen aktuale ekonomike ne duhet më shumë se kurë ta përforcojmë rolin e partnerëve social dhe ta përforcojmë dialogun social. Shtetet të cilët për momentin përparojnë më së shumti janë ata ku partnerët social janë më të fuqishëm. Ata sikurse e kanë gjetur fshehtësinë pas vendosjes së "kulturës së partneritetit" mes institucioneve nacionale, biznesit dhe sindikatave – partneriteti i cili mund të sjellë prosperitet për të gjithë qytetarët, duke e bërë realitet "punësimin dhe rritjen.

Andaj, është me rëndësi të reflektohen këto çështje. Unë besoj se diskutimi i juaj sot do të jetë i gjallë dhe i frytshëm – dhe unë do ti pres propozimet të cilat Komiteti i përbashkët konsultativ do ti jep pas debatit për çështje të interesit të përbashkët.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj